



Pranuar / Dorezuar / Priljevu / Predato / Received / Delivery	30.06.2022	2	viti / god / year
Organ / Njësia / Organ / Jedinica / Org. / Unit	Nr. Prot / Br. Prot / Prot. No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKPM/SHK	3832	2022	113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.519/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.519/2022 të datës 10.06.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi në

kundër Vendimit me numër 32/AMMK/2022 të datës 07.06.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.519/2022 e datës 10.06.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Agjencinë e Mbrojtjes së Mjedisit më datë 10.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3377/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 32/AMMK/2022 të datës 07.06.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, lidhur me caktimin e zëvendësues i Zyrtarit për Projekte dhe Bashkëpunim në Divizionin për Gjendjen e Mjedisit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 15.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe

Infrastrukturës. Ndërsa Këshilli më datë 17.06.2022, ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 3377/2022 të datës 10.06.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.06.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 3535 të datës 17.06.2022; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 04.10.2019; Vendimin me numër 32/AMMK/2022 dhe Nr. Prot:3271/22 të datës 07.06.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 05.09.2018; Organogramin e AMMK; Diplomën me Nr. D.847/20 e datës 24.08.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale, ka konstatuar se ankesa e ankueses: **është e palejuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja në bazë të Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 04.10.2019, është e punësuar në pozitën *Udhëheqëse e Sektorit për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim*, në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës më datë 07.06.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër 32/AMMK/2022 me të cilin ka caktuar nëpunësin *asistent administrativ* në Divizionin për Gjendjen e Mjedisit si zëvendësues i Zyrtarit për Projekte dhe Bashkëpunim në Divizionin për Gjendjen e Mjedisit.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së Vendimi me numër 32/AMMK/2022 i datës 07.06.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*, Kolegji i Këshillit vlerëson se me vendimin e kundërshtuara me ankesë nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankueses lidhur me marrëdhënien e saj të punës rrjedhimisht ankuesja nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridike, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.519/2022 e datës 10.06.2022, e parashtruar nga ankuesja **është e papranueshme.**

Siç u vërtetua me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.519/2022

Avdyll BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- Arkivit të KPMSHCK-së

